

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-034/12

Prishtinë

12 dhjetor 2012

Në çështjen juridike të:

M.S

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

1. M.A, i përfaqësuar nga E.Q (Avokat)
2. D.A
3. S.A
4. N.B
5. B.H

Palët përgjegjëse në kërkesë /Palët përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/120/2011

(lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA13473, KPA13474, KPA13475, KPA13476 dhe KPA13477), të datës 7 shtator 2011 dhe në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/122/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13478), të datës 7 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me datën 12 dhjetor 2012, morri këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Vërtetohen vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/120/2011 të datës 7 shtator 2011, lidhur me lëndët e regjistruara me numrat KPA13473, KPA13474, KPA13475, KPA13476, KPA13477, dhe KPCC/D/R/122/2011, të datës 7 shtator 2011, lidhur me lëndën e regjistruar me numrin KPA13478.

- 2- Pala ankuese detyrohet t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë), brenda afatit 90 (nëntëdhjetë) ditore nga data e dorëzimit të aktgjykimit nën kanosjen e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 18 shtator 2006, M.S ka paraqitur gjashtë kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar të njihet si bashkëpronar me ¼ në disa ngastrat kadastrale dhe një shtëpi të fituar me trashëgimi duke kërkuar ri-posedimin. Ai theksonte se këto ngastra ishin humbur më 12 qershor 1999 për shkak të rrethanave në Kosovë në vitet 1998/99.

Ngastrat kadastrale nga Fletat Poseduese Nr. 363 dhe Nr. 382 të lëshuara nga Zyra Kadastrale në Gjilan të lëshuara me datë 29 gusht 2006, janë si vijon:

Numri i ankesës dhe i lëndës së AKP-së	Të dhënat e ngastrave
GSK-KPA-A-034/12 (KPA13473)	Fleta Poseduese nr. 363, ngastra nr. 190/1, në vendin e quajtur "MERAJA VLADOVO" në Lladovë, Komuna e Gjilanit, arë e klasit të tretë me sipërfaqe prej 46 ari dhe 91 m ² ;
GSK-KPA-A-035/12 (KPA13474)	Fleta Poseduese nr. 363, ngastra nr. 197/2, në vendin e quajtur "MERAJA" në Lladovë, Komuna e Gjilanit, arë e klasit të katërt me sipërfaqe prej 42 ari dhe 40 m ² ;

GSK-KPA-A-036/12 (KPA13475)	Fleta Poseduese nr. 363, ngastrat nr. 227/2, 227/3 dhe 228/2 në vendin e quajtur "SUKA RID" në Lladovë, Komuna e Gjilanit, arë e klasit të katërt me sipërfaqe prej 1 ha, 7 ar dhe 89 m ² ;
GSK-KPA-A-037/12 (KPA13476)	Fleta Poseduese nr. 382, ngastra nr. 319/2, në vendin e quajtur "BEZIMENI" në Llashticë, Komuna e Gjilanit, a kullosë e klasit të dytë me sipërfaqe prej 22 ari dhe 60 m ² ;
GSK-KPA-A-038/12 (KPA13477)	Fleta Poseduese nr. 382, ngastra nr. 325/1 në vendin e quajtur "JARUGA" në Llashticë, Komuna e Gjilanit, kullosë e klasit të dytë me sipërfaqe prej 18 ari dhe 60 m ² ;
GSK-KPA-A-039/12 (KPA13478)	Fleta Poseduese nr. 382, ngastra nr. 2582/1 në vendin e quajtur "PRZHAR DVORISHTE" në Llashticë, Komuna e Gjilanit, një shtëpi me sipërfaqe prej 130.4 m ² ;

Për të mbështetur kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës i ka siguruar AKP-së, në mes tjerash, dokumentacionin vijues:

- Fletën Poseduese nr. 363 të lëshuar nga Republika e Serbisë, Enti Gjeodezik Republikan, Komuna e Gjilanit, Zona Kadastrale Lladovë më 29 gusht 2006, që paraqet se ngastrat e kërkuara ishin të regjistruara në emër të M.S si bashkëpronar me pjesën ¼ të pronës;
- Fleta Poseduese nr. 382 e lëshuar nga Republika e Serbisë, Enti Gjeodezik Republikan, Komuna e Gjilanit, Zona Kadastrale Llashticë më 29 gusht 2006, që konstaton se ngastrat e kërkuara ishin të regjistruara në emër të M.S si bashkëpronar me pjesën ¼ të pronës;
- Vendimin mbi Trashëgiminë T.nr. 55/70, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit më 21 dhjetor 1971, sipas të cilit M.S ka trashëguar ¼ e pasurisë së tërësishme të paluajtshme të gjyshit të tij P.S;
- Kontratën për ndarjen e pronës së paluajtshme Cv.br.1213/79 të lidhur më 2 nëntor 1979 në Gjilan në lidhje me disa ngastrat e kontestuara;
- Për GSK-KPA-A-034/12 (KPA13473) dhe GSK-KPA-A-035/12 (KPA13474): aktgjykimin P.nr. 267/86, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit më 19 shtator 1986, ku pala e dëmtuar është M.S, ku dënohet B.A për shkak të kryerjes së veprës penale të falsifikimit të dokumenteve publike;
- Për GSK-KPA-A-034/12 (KPA13473) dhe GSK-KPA-A-035/12 (KPA13474) procesverbalin e gjykatës C.nr.I-860-89, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit më 5 qershor 1990, në lidhje me një vizitë në terren për të zbatuar vendimin final të Gjykatës

Komunale të Gjilanit C.nr. 57/87 të datës 11 shtator 1987, i cili anulonte kontratën e shitjes të datës 15 gusht 1975:

AKP vërtetoi, në bazë të raportit të verifikimit të datës 20 dhjetor 2006, Fletat Poseduese nr. 363 dhe 382. Vendimi mbi trashëgiminë T.nr. 55/70 ishte gjetur në Gjykatën Komunale të Gjilanit dhe kontrata mbi ndarjen Cv.br.1213/79 ishte vërtetuar pozitivisht.

AKP kishte organizuar disa herë notifikimin e kërkesave. Ekipi për njoftim kishte shkuar në lokacionet ku ngastrat pretendohesh se ekzistonin dhe kishin vendosur shenja që tregonin se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhej të dërgonin përgjigjet e tyre brenda 30 ditësh. Më në fund në vitin 2010, të gjitha notifikimet ishin kontrolluar në bazë të të dhënave kadastrale, GPS koordinatave dhe ortofotos dhe ishin gjetur të kishin qenë të sakta.

Palët përgjegjëse në kërkesë dorëzuan në AKP (në mes tjerash) dokumentet dhe deklaratat shtesë me sa vijon:

- Për GSK-KPA-A-034/12 (KPA13473) pala përgjegjëse në kërkesë M.A përmes avokatit të tij E.Q dorëzoi aktgjykimin C.nr. 473/75, lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit më 7 tetor 1977, në lidhje me një kontest toke në mes të B.S dhe B.A;
- Për GSK-KPA-A-034/12 (KPA13473) dhe GSK-KPA-A-035/12 (KPA13474) pala përgjegjëse në kërkesë M.A, trashëgimtar i B.A, përmes avokatit të tij E.Q dorëzoi një tjetër aktgjykim, P.nr. 263/85, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit më 23 tetor 1986, që vërtetonte vendimin C.nr. 119/85, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit më 8 maj 1985;
- Për GSK-KPA-A-036/12 (KPA13475) pala përgjegjëse në kërkesë D.A thekson se prona e kishte blerë nga M.S në vitin 1971. Ai shpjegon se dokumentacioni ishin djegur gjatë luftës në vitin 1999 dhe se ai kishte paguar tatimin në pronë që nga viti 1971;
- Për GSK-KPA-A-037/12 (KPA13476) pala përgjegjëse në kërkesë S.A thekson se babai i tij G.A e kishte blerë pronën e kërkuar në vitin 1972, atë kohë nuk ishte bërë kontratë e shitblerjes dhe sipas S.A familja e parashtruesit të kërkesës ishte shpërngulur në Beograd në vitin 1972;
- Për GSK-KPA-A-038/12 (KPA13477) pala përgjegjëse në kërkesë N.B thekson se babai i tij XH.B e kishte blerë pronën nga M.S në vitin 1973. Dokumentet ishin djegur gjatë luftës në vitin 1999;

- Për GSK-KPA-A-039/12 (KPA13478) pala përgjegjëse në kërkesë B.H thekson se vëllai i tij i madh S.H.1 e kishte blerë pronën dhe ai e ka posedimin që nga viti 1976. B.H prezanton një faturë me shkrim dore për një shtëpi dhe ngastër të datës 21 janari 1976 dhe një faturë tjetër me shkrim dore të datës 23 janar 1977 ku shitësi thekson se çmimi i blerjes prej pesë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë Dinarë është paguar për një arë dhe një mal nga S.H.2, ku pretendohet se është nënshkruar nga Milutin STAMENKOVIĆ dhe S.H.1.

AKP vërtetoi pozitivisht Aktgjykimin C.nr.119/85 dhe Aktgjykimin P.nr.263/85.

Me datën 7 shtator 2011, KKPK në vendimet e tij KPCC/D/A/120/2011 dhe KPCC/D/R/122/2011 hedh poshtë kërkesat. Vendimi KPCC/D/R/122/2011 thotë: “Pasi që parashtruesi i kërkesës pohon se ai e kishte lëshuar Kosovën gjatë viteve 1970-ta dhe ishte shpërngulur për në Beograd ku ai vazhdon të jeton. Parashtruesi i kërkesës thekson se prona e kërkuar është uzurpuar nga persona të panjohur për të që nga atëherë. Rrjedhimisht, nëse prona e kërkuar është uzurpuar qysh në vitet e 1970-ta, humbja në posedim siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës, nuk mund të ndërlidhet me konfliktin e viteve 1998-99.”

Vendimi i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 dhjetor 2011. Në dhjetor 2011, vendimi i ishte dorëzuar palëve përgjegjëse në kërkesë respektivisht përfaqësuesit të palës përgjegjëse në kërkesë.

Më 10 janar 2012, parashtruesi i kërkesës (tani e tutje: pala ankuese) ka dorëzuar një ankesë në Gjykatën Supreme.

Pala ankuese ka kundërshtuar vendimin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të fakteve. Ai ka theksuar se asnjëherë gjatë procedurës ai nuk e kishte informuar AKP-në se e kishte humbur posedimin para luftës së 1998-99, siç theksohet në vendimet e KKPK-së. Ai e pranon se që nga vitet e 80-ta ai kishte konteste para gjykatave kompetente dhe organeve tjera shtetërore me palët përgjegjëse në kërkesë ose prindërit e tyre për shkak të pengimit në posedim dhe falsifikimit në lidhje me ngastrat. Ai thekson se të gjitha procedurat janë kryer në favor të tij nga autoritetet kompetente gjyqësore dhe këto vendime ishin zbatuar dhe palët përgjegjëse në kërkesë ishin larguar gjatë viteve të 80-ta dhe të 90-ta nga prona e tij nga autoritetet kompetente por ata kishin vazhduar të pengonin kohë pas kohe në shfrytëzimin e pronës së tij me veprimet e tyre të cilat nuk ishin të karakterit të përhershëm por të përkohshëm. Pala

ankuese kërkon anulimin e vendimeve të KKKP-së dhe që njejtat të kthehen në rishqyrtim në AKP ose duke vendosur në lidhje me posedimin e pronës së kërkuar.

Ankesa i është dorëzuar palëve përgjegjëse në ankesë në 29 shkurt 2012. Palët përgjegjëse në ankesë nuk kanë dorëzuar përgjigje ndaj ankesës brenda afatit 30 ditorë.

Gjykata i ka bashkuar lëndët.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është dorëzuar brenda afatit 30 ditorë siç parashihet me ligj (Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Sidoqoftë ajo nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të të Gjykatës Supreme të Kosovës i drejtë dhe i ligjshëm është konkludimi juridik i KKKK-ës kur ka vendosur që kërkesat e paraqitura nuk janë në kuadër të jurisdiksionit të tij dhe se ky vendim nuk është marrë me shkelje esenciale të LPK-ës.

Sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse parashtruesi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon të drejtën në pronësi por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat e tilla pronësore për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Siç duket qartë, kanë ekzistuar kontestet në lidhje me pronën në mes të palës ankuese dhe palëve përgjegjëse në ankesë që na vitet e 1970-ta. Duke filluar me Vendimin mbi Trashëgiminë T.nr.55/70, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Gjilan më 21 dhjetor 1971 duke vazhduar me kontestet në vitet e 1980-ta, për shembull Aktgjykimi P.nr.263/85, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Gjilan më 23 tetor 1986, që vërteton Vendimin C.nr.119/85 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit më 8 maj 1985. Pala ankuese pranon në ankesën e tij se që nga vitet e 80-ta ai ka pasur konteste para gjykatave kompetente lidhur me pengimin në posedim të ngastrave të kontestuese.

Në dosje, gjykata ka gjetur një shënim të zyrtarit të AKP-së të datës 15 gusht 2011, i cili përshkruante bisedën me palën ankuese në lidhje me pronën e kërkuar: “ES kishte kontaktuar Parashtruesin e kërkesës në mënyrë që të sqaroj se pse ai në kërkesë ka theksuar se e ka humbur posedimin mbi

pronën e kërkuar gjatë vitit 99 dhe pastaj ka theksuar se e ka humbur posedimin mbi pronën e kërkuar në vitin 1970. Parashtruesi i kërkesës ka theksuar se ai e ka lëshuar Kosovën në vitin 1970 dhe kishte shkuar në Beograd ku edhe tani jeton. Ai nuk ka dhënë asnjë shpjegim se pse ekziston kjo mospërputhje në mes të deklaratave të tij. ES gjithashtu ka dashur të dijë nëse ishte bërë ndonjë blerje e ngastrave të kërkuara. Parashtruesi i kërkesës fillimisht e mohoi se kishte shitje, megjithatë pasi që i ishte përmendur se ekzistonte Aktgjykimi në dosjen e kërkesës, dorëzuar nga RP, që përmend një blerje e pronave nga fp.363, ai e pranoi se ishte bërë një shitje por nga e ëma e tij dhe se ai nuk dinte më shumë ...”

Pala ankuese nuk e ka dëshmuar se kontesti në lidhje me pronën në fjalë dhe humbja e pronës ka ndonjë lidhshmëri me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999 por me shpërnguljen e palës ankuese në Beograd në vitet e 1970-ta dhe me kontestet e vazhdueshme që nga vitet e 1970-ta.

Prandaj, Gjykata konstaton se lëndët nuk janë në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të saj në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite, Gjykata Supreme ka juridiksion në rast se të drejtat pronësore nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur brenda periudhës prej 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999. Për sa i takon lëndëve në fjalë, çështja lëndore e kërkesës duket qartë të jetë e ndërlidhur me konfliktet e vjetra në mes të palës ankuese dhe palëve përgjegjëse në ankesë që kishin ekzistuar para konfliktit të armatosur dhe nuk ndërlidhet me këtë konflikt.

Në bazë të gjithë kësaj, është dashur që ankesat të refuzoheshin dhe të vërtetohej vendimi i KKPK-së për sa i takon pronës së kontestuar.

Vendimi i gjykatës nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar vërtetimin e pronës së tij para gjykatave kompetente.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, Neni 8.4 i Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të

Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, 10.12, 10.1 dhe 10.15 mutadis murandis të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të llogaritet të jetë mbi € 100.000: € 30 (€ 50 + 0.5% nga 90.000, por jo më shumë se € 30).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuuese e cila humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë e më i gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjykata përcakton që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent, EULEX.